



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/66
Datë: 18.09.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 shtator 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës ("MASHT") dhe Stitching Spark-ut të Holandës ("SPARK") mbi mbështetjen e Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit Mitrovica.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/66
Datë: 18.09.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 shtator 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Strategjia për Rregullim më të Mirë 2.0 për Kosovën 2017 - 2021.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Strategjisë nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/66
Datë: 18.09.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 dhe 50 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 shtator 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni Ekzekutiv për Reformën në Fushën e Inspektimeve në këtë përbërje:
 - 1.1. Koordinatori Nacional për Reforma Shtetërore/Kryesues;
 - 1.2. Shefi i Kabinetit, MTI/Zëvendës Kryesues;
 - 1.3. Sekretari i Përgjithshëm, MAPL/anëtar;
 - 1.4. Drejtori i Zyrës për Planifikim Strategjik, ZKM/anëtar;
 - 1.5. Drejtori i Departamentit Ligjor, MTI/anëtar;
 - 1.6. Drejtori i Departamentit Ligjor, MF/anëtar;
 - 1.7. Drejtori i Departamentit Ligjor, MAP/anëtar.
2. Komisioni Ekzekutiv gjithashtu obligohet të ftojë përfaqësues të shoqërisë civile, sektorit privat, institucioneve të tjera dhe donatorëve ndërkombëtarë për të marrë pjesë në mënyrë aktive në punën e tij në cilësi të ekspertëve dhe/ose vëzhguesve.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të Komisionit Ekzekutiv për këtë reformë me interes nacional, janë si vijon:
 - 3.1. Koordinimi, drejtimi dhe mbikëqyrja e aktiviteteve të organeve të ndryshme qeveritare për zbatimin e aktiviteteve që ndërlidhen me reformën e fushës së inspektimeve;
 - 3.2. Koordinimi i aktiviteteve me institucionet e pavarura dhe nivelin lokal sa i përket reformës në fushën e inspektimeve;
 - 3.3. Përgatitja e propozimeve dhe projekt-vendimeve të nevojshme për zbatimin e suksesshëm të reformës në fushën e inspektimeve për vendosje nga organet kompetente Qeveritare, duke përfshirë propozimin për racionalizimin e numrit të inspektorateve dhe koordinimin më të mirë të tyre që pritet të dorëzohet në mbledhjen e Qeverisë për miratim;
 - 3.4. Mbikëqyrja e procesit të hartimit legjislativ të nevojshëm për implementimin e reformës në fushën e inspektimeve, duke përfshirë sigurimin e udhëzimeve të nevojshme të politikave në përputhje me Koncept Dokumentin e aprovuar me Vendimin e Qeverisë Nr. 17/35 të datës 09.03.2018;

- 3.5. Mbikëqyrja e grupeve të specializuara në kuadër të organeve qeveritare ose grupeve të specializuara ndër-qeveritare të cilat themelohen me kërkesë të Komisionit Ekzekutiv dhe i raportojnë atij, për trajtimin e çështjeve të caktuara lidhur me këtë reformë;
 - 3.6. Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve të nevojshme udhëzuese për implementimin e suksesshëm të reformës në fushën e inspektimeve;
 - 3.7. Zhvillimi i aktiviteteve të tjera të nevojshme për implementimin e suksesshëm të reformës së inspektimeve në përputhje me Koncept Dokumentin e aprovuar me Vendimin e Qeverisë Nr. 17/35 të datës 09.03.2018;
4. Brenda dyzet e pesë (45) ditëve kalendarike nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, Komisioni Ekzekutiv do të hartojë dhe aprovojë Rregulloren e tij të Punës dhe Planin e Veprimit për zbatimin e Reformës në Fushën e Inspektimeve.
 5. Të gjitha organet dhe zyrtarët qeveritar obligohen që të bashkëpunojnë me Komisionin Ekzekutiv gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësive të përcaktuara në këtë vendim.
 6. Mbledhjet e Komisionit Ekzekutiv mbahen vetëm nën kryesimin e zyrtarëve të emëruar në pikat 1.1. ose 1.2. të këtij vendimi. Përgjatë, në mungesë të zyrtarëve të emëruar në pikat 1.1. ose 1.2. të këtij vendimi, mbledhjet e Komisionit Ekzekutiv zhvillohen nën kryesimin e përkohshëm të zyrtarit të përcaktuar në pikën 1.4. të këtij vendimi, deri në nxjerrjen e një vendimi tjetër nga Qeveria e Republikës së Kosovës.
 7. Në rast të ndryshimit ose lirimit të pozitave në pikat 1.1. dhe 1.2. të këtij vendimi, me Vendim të Qeverisë mund të emërohet Kryesuesi, respektivisht Zëvendës-Kryesuesi i Komisionit Ekzekutiv, të cilët duhet të jenë të paktën në nivel të njëjtë me pozitën përkatëse të përcaktuara në këtë vendim. Anëtarët e tjerë shërbejnë në Komisionin Ekzekutiv sipas detyrës zyrtare.
 8. Shërbimi në Komisionin Ekzekutiv trajtohet si pjesë e detyrave të rregullta të punës të të gjithë anëtarëve.
 9. Të gjithë anëtarët e Komisionit Ekzekutiv obligohen që të marrin pjesë personalisht dhe vazhdimisht në të gjitha mbledhjet e thirrura. Në raste të jashtëzakonshme, kur pjesëmarrja nuk është e mundur, anëtari përkatës obligohet që të njoftojë Kryesuesin, Zëvendës Kryesuesin dhe zyrtarin nga pika 1.4. e këtij vendimi për mungesën dhe të kërkojë aprovim për zëvendësimin e tij/saj nga një person tjetër nga institucioni i njëjtë.
 10. Në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësive të përcaktuara në këtë vendim, Komisioni Ekzekutiv mbështetet në aspekt administrativ dhe profesional nga Zyra për Planifikim Strategjik dhe Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit dhe Departamenti Ligjor në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Mbështetje në aspekt profesional do të ofrojë edhe Projekti i Bankës Botërore për Konkurrueshmërisë dhe Gatishmërisë për Eksport dhe Projekti i IFC për Përmirësimin e Klimës së Investimeve, financuar nga Qeveria Zvicerane.
 11. Organizimi dhe modalitetet tjera të mbështetjes administrative dhe profesionale sipas pikës 10. të këtij vendimi, vendosen në mbledhjen e parë të Komisionit Ekzekutiv.
 12. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/66

Datë: 18.09.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ Mf - nr. 04/2013 për Vlerësimin e Rrezikut Kombëtar të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, duke shqyrtuar propozimin e Ministrisë së Financave, të datës 14.09.2018, me nr. prot. 1622/1, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 shtator 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Vlerësimi i Rrezikut Sektorial në Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit në Sektorin e Organizatave Joqeveritare/Jofitimprurëse (OJQ-ve/OJF-ve) në Kosovë.
2. Obligohet Ministria e Financave dhe Njësia e Inteligjencës Financiare për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/66

Datë: 18.09.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke shqyrtuar propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë, të datës 11.09.2018, me nr. prot. 05-5688/4, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 shtator 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kompensimi për punën e Bordit Drejtues të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, sipas shtojcës pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Kompensimi për Bordin Drejtues të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore dhe Sekretarin ekzekutohet në mënyrë retroaktive nga data 19.04.2018 bazuar në vendimin e Qeverisë për emërimin e Bordit, vendimi Nr. 11/42 i datës 19.04.2018.
3. Kompensimi i këtij Bordi bëhet nga Buxheti i Fondit për Sigurime Shëndetësore.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Shtojca 1: Skema e kompensimit për Bordin Drejtues të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore të Republikës së Kosovës

	Pozicioni	Kompensimi maksimal mujor
1.	Kryesues	850 €
2.	Anëtar	750 €
3.	Sekretar	220 €

Vërejtje: Nuk mund të tejkalohet shuma e kompensimit maksimal mujor



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/66

Datë: 18.09.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 12 të Ligjit Nr. 04/L-144 Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 shtator 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Propozimi i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për kërkesën e Komunës së Pejës për tërheqjen nga procesi i privatizimit dhe kthimin në pronësi të komunës me qëllim të realizimit të Planit Zhvillimor Komunal.
2. Zonat Kadastrale të cilat janë objekt i këtij vendimi janë: ngastrat me nr. 687/2; nr. 942-1; nr. 942-2; nr. 5333-2; nr. 284-1; nr. 4746/1; nr. 387/2; nr. 4548; nr. 3339/2; nr. 522/1 me sipërfaqe prej 9623 m² ZK Brestovik; nr. 522/2 me sipërfaqe prej 15923 m² ZK Brestovik; si dhe NSH Produkt dyqani në Asllan Qeshme me sipërfaqe prej 78m².
3. Kompensimet e Agjencisë Kosovare të Privatizimit në shumën prej njëzet për qind (20%) të vlerës së pronës sipas vlerësimit, për të kompensuar punëtorët e kualifikuar të Ndërmarrjes Shoqërore, si dhe kërkesat e kreditorëve nga procesi i likuidimit deri në shumën e përgjithshme të vlerësimit, do të bëhet sipas legjislacionit përkatës në fuqi.
4. Prona nga pika 2. e këtij vendimi, nuk mund të shfrytëzohet për qëllime të tjera, përveç destinimit të përcaktuar.
5. Obligohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal që të zhvillojë procedurat e mëtejme me Agjencionin Kosovar të Privatizimit, deri në vendimin përfundimtar për bartje të pronës.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/66

Datë: 18.09.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 shtator 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Udhëzimi Administrativ për mënyrën e emërimit të Trupave për Vlerësim të Konformitetit.
2. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Udhëzimit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/66

Datë: 18.09.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 shtator 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për lidhjen e Marrëveshjes për Sigurime Sociale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Sllovenisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Përgjatë negociimit të kësaj Marrëveshjeje, obligohet Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/66

Datë: 18.09.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 shtator 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Anullohet Vendimi i Qeverisë Nr. 10/57 i datës 17.07.2018.
2. Plani kryesor xehetarë për minierën e re për nevojat e kapaciteteve të reja gjeneruese elektrike të tashme dhe të ardhshme të jetë versioni N1, siç është definuar edhe nga operatori ekonomik Mibrag (konsulent i KEK).
3. Obligohet KEK që brenda një periudhe një mujore të hartojë planin kryesor xehetarë dhe të bëj përditësimin e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe social.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/66

Datë: 18.09.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 75 paragrafi 1. të Ligjit Nr. 06/L-026 për Azil, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 shtator 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

- Themelohet Komisioni Kombëtar për Refugjatë në këtë përbërje:
 - 1.1. Naim Shala, Ministria e Punëve të Brendshme - kryetar;
 - 1.2. Leunora Ahmeti, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - zëvendëskryetare;
 - 1.3. Nehat Pllana, Zyra e Kryeministrit - anëtar;
 - 1.4. Shkelqim Jakupi, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal - anëtar;
 - 1.5. Ruzhdi Osmani, Ministria e Drejtësisë - anëtar;
 - 1.6. Aferdita S. Hoxha, Ministria e Shëndetësisë - anëtare;
 - 1.7. Arbnor Ajeti, Ministria për Komunitete dhe Kthim - anëtar.
- Komisioni është i pavarur në punën e tij.
- Mandati i komisionit është tre (3) vjet dhe veprimtarinë e tij e ushtron në bazë të Ligjit për Azil dhe legjislacionit relevant në fuqi.
- Komisioni vendosë në këshilla prej tre anëtarësh, dhe i njëjti merr vendime me shumicë votash.
- Përfaqësuesi i UNHCR-së, merr pjesë në punën e Komisionit në cilësinë e vëzhguesit.
- Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme për sigurimin e hapësirës dhe mbështetjes teknike për Komisionin me qëllim të ushtrimit të veprimtarisë së tij.
- Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr. 08/30 i datës 20.05.2015.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë